



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

NR. 3, DATË 22.08.2014

PËR MIRATIMIN E NISMËS PËR PËRCAKTIMIN E DISA ÇËSHTJEVE / ZONAVE
TË RËNDËSISË KOMBËTARE NË PLANIFIKIMIN E TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 5, 6, 8, 32 dhe 64 të Ligjit Nr. 10119, date 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe të VKM-së Nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nismës për përcaktimin e disa çështjeve / zonave të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit, sipas vendimit përkatës të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe dokumentave shoqëruese të tij, që i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për kryerjen e procedurave të bashkërendimit, këshillimit dhe dëgjimit publik, në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara nga ligji.
3. Ngarkohen autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe autoritetet e inspektimit, në nivel vendor dhe kombëtar, për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për pezullimin e zhvillimit në zonën e rëndësisë kombëtare, deri në përcaktimin e rëndësisë kombëtare të çështjeve / zonave.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

